

Alb-Ind Tours & Travels

AKT THEMELIMI

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Sot, më datë 02/06/2023, në Tirane, Z. Mohammed Hamed Khan, shtetas indian, me zotësi juridike të plotë për të vepruar, i datëlindjes 23/04/1996, mbajtës i dokumentit të identifikimit pasaporte me numër V3742626, nënshkruan këtë akt themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emër Alb-Ind Tours & Travels.

Neni 1

Forma e shoqërisë

Ortaku themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në kuptimin që përgjegjësia e tyre është e kufizuar deri në shumën e kapitalit të derdhur, pa iu njohur asnjë përgjegjësi tjetër.

Neni 2

Emërtimi i shoqërisë

Emërtimi i shoqërisë është Alb-Ind Tours & Travels.

Neni 3

Baza juridike

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe në përputhje me dispozitat e statutit dhe aktit të themelimit të saj.

MOHAMMED HAMED KHAN
Mohammed Khan

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

4.1 Shoqëria Alb-Ind Tours & Travels përcakton objektin e saj si më poshtë:

4.2 Ndermejetesim ne tregun e punës ne Shqiperi dhe jashtë saj, si dhe çdo veprimtari tjetër të nevojshme për realizimin e qëllimit të shoqërisë që nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

4.3 Shoqëria, me vendim të administratorit, mund te lidhe marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprimtari tregtare që konsiderohet e nevojshme me qëllim arritjen e objektit të saj.

4.4 Për të realizuar qëllimet e saj, shoqëria mund të sigurojë dhe përdorë financime nga ortakët, nga vende të tjera si dhe nga institucione financiare vendase ose te huaja.

4.5 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet apo të kufizohet në bazë të vendimit të ortakut.

Neni 5

Selia

Shoqëria Alb-Ind Tours & Travels ka selinë në adresën:

Tiranë, Rruga Ndre Mjeda, Zona Kadastrale Nr. 8220, Nr. Pasurie 5/30+1-6, Volumi nr. 6, Fq. 230, Pallati 4, Shkalla 3, Apartamenti 6.

Në këtë adresë do të ushtrohet aktiviteti kryesor i shoqërisë.

Neni 6

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pa përcaktuar.

MOHAMMED HAMED KHAN
Mohammed Khan

Neni 7

Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 50 000 (pesedhjetë mijë) lekë.

Neni 8

Administrimi

Administrator i shoqërisë do të jete:

Z. Mohammed Hamed Khan, person me shtetësi indiane, i datëlindjes 23/04//1996, mbajtës i dokumentit të identifikimit pasaporte me numërV3742626. Afati i emertimit të administratorit do të jetë për një periudhe 5 vjecare nga 02/06/2023 deri në 01/06/2028 me të drejtë riemërimi.

Neni 9

Viti financiar

Vitet financiare përputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon në 1 Janar dhe mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Përrjashtimisht, viti i parë financiar do të fillojë nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe do të mbyllet në fund të vitit përkatës.

Neni 10

Të ardhurat neto

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve themelues të shoqërisë në raport me kuotat e tyre në kapital. Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, në përputhje me parashikimet e statutit dhe pas shlyerjes së detyrimeve tatimore dhe rezervës së domosdoshme, të konkretizuara në pasqyrat dhe raportet financiare të çdo viti financiar, mund të

MOHAMMED HAMED KHAN

MR Hamed Khan

ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë, ose mund të ri investohen si kapital i shoqërisë.

Neni 11

Juridiksioni

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre janë gjykatat shqiptare.

Ky akt themelimi i shoqërisë Alb-Ind Tours & Travels me përgjegjësi të kufizuar është hartuar në 5 (pese) kopje në gjuhën Shqipe dhe pasi lexohet, nënshkruhet nga ortaku themelues.

Ortaku i Shoqërisë

Alb-Ind Tours & Travels

Mohammed Hamed Khan

MOHAMMED HAMED KHAN

Mohammed Hamed Khan